

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data: 07.01.2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X ose

Emri: A l b G a r d e n shpk

Nipti: K37513520N

Adresa: Lezhe, Lagjja "Skenderbeg", godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: Shërbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 61164-09-11-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore**

Fondi limit: 32,115,167.55 (tridhjetë e dy milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e pesë) **lekë, pa TVSH ose 330,777.29** (treqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e nëntë) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 11.09.2025 97.09 lekë/euro).

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 23.10.2025.

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Nr. 63, datë 27.10.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. REJ shpk NIPT: J93711608Q
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 19,482,000 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

2. ASI INVEST shpk NIPT: M01927023H
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 21,510,000 (njëzet e një milion e pesëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

3. A l b G a r d e n shpk NIPT: K37513520N
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 22,278,000 (njëzet e dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

4. CARA shpk NIPT: K07729920F
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 25,500,000.00 (njëzet e pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

5. B.O.E AGRO - KORANI shpk & KURORA shpk NIPT: L13329801V & J76314803S
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 25,608,000 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

6. Gjelbërimi 2000 shpk NIPT: L21513012D
 Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 26,252,850 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor
 PO ☐ JO X

7. Pastrime Silvio shpk NIPT: K91413010N

Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 30,634,500 (tridhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

8. CLEAN FAST shpk

NIPT: L61807037R

Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 30,785,382 (tridhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. REJ shpk

NIPT: J93711608Q

arsyet

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin 2.3.1. të kapacitetit teknik ku kerkohet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në përmbushje të këtij kriteri OE “REJ” shpk, me NUIS J93711608Q ka paraqitur kontrata/vertetime realizimi/fatura për objekte të ndryshme, përkatësisht si më poshtë:

- Kontrata me objekt “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësi Administrative”;
- Kontrata me objekt “Kontratë shërbimi për punime të mirëmbajtjes rrugore për HEC-Cemerica 1,2,3”;
- Kontrata me objekt “Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore”;
- Kontrata me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Zemblak – Ligenas – Dog. Goricë, Libonik – Rrëmbec – Plasë”.

Referuar situacioneve të paraqitura në SPE nga OE “REJ” shpk, në përmbushje të kontratave të mësipërme, rezulton se zërat konkrete të shërbimeve të kryera janë:

“pastrim kanalesh/pastrim tombinosh/riparim i gropave të asfaltit/ riparim dhe rifreskim i sinjalistikës/ mirëmbajtje dimërore/ fshirje sip. të asfaltuara fshesë dore/ ngarkim + transport mbeturinash familjare/ dezinj. i konteniereve me gëlqere/ pastrim i thellë lumenjsh me eskavator/ ngarkim + transport të (inerte)/ lagje dhe freskim rrugësh, etj...”

Në dokumentet e tenderit, shtojca 7 është përshkruar natyra e shërbimit të kërkuar sipas tabelës 1, përkatësisht:

Nr.	Përshkrimi
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre
2	Kositje bari dhe largimi i tyre
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)
5	Mirembajtje pemesh dhe shkurresh
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale
8	Furnizim vendosje stolash te rinj
9	Mirëmbajtje stolash ne ambjentet e jashtme
10	Furnizim vendosje kosha duhani

Nga sa më sipër, rezulton se zërat e shërbimeve në kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk janë të ngjashëm me asnjë nga zërat e kërkuara në specifikimet teknike, në procedurën e prokurimit me objekt, **“Kryerje e shërbimit të Gjëlberimit në SUT”**.

Në këto kushte rezulton se OE “REJ” shpk, me NUIS J93711608Q nuk ploteson kriterin 2.3.1. te kapacitetit teknik pasi nuk vërteton se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. CARA shpk

NIPT: K07729920F

arsyet

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin 2.3.1. te kapacitetit teknik ku kerkohet, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Sa me sipër Operatori ekonomik “CARA” shpk, me NUIS K07729920F rezulton se kontratat/faturat/situacionet e paraqitura ne SPE nuk kane ngjashmeri me asnje nga zerat e kerkuara ne specifikimt teknike, ne proceduren e prokurimit me objekt: **“Kryerje e shërbimit të Gjëlberimit në SUT”**.

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin 2.3.3. të kapacitetit teknik ku kërkohej: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Prodhim dhe tregtim të produkteve të mbrojtjes së bimëve” Kodi II.5.A.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “CARA” shpk, me NUIS K07729920F rezulton se ky operator nuk ka dorezuar Licensën perkatese të kërkuar në kriteret e vecanta në dokumentat e tenderit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

3. Gjelbërimi 2000 shpk

NIPT: L21513012D

arsyet

Operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000” sh.p.k., me NUIS L21513012D i mungon kapaciteti ligjor për realizimin e kontratës, pasi licenca e paraqitur në ofertë nuk është në pronësi të tij dhe rezulton të jetë marrë në përdorim përmes një marrëveshjeje “qiraje”, e cila është në kundërshtim me natyrën juridike të licencës si leje administrative me karakter personal dhe të pa-transferueshëm.

Sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, si dhe dispozitat e posaçme për fushën përkatëse (p.sh. ndërtim, transport, energji etj.), licenca është e lidhur ngushtësisht me subjektin që e ka marrë dhe nuk mund të jepet me qira apo të transferohet te palë të treta pa autorizim të posaçëm nga organi përkatës licencues.

Prandaj, operatori ekonomik nuk përmbush kërkesat ligjore për kualifikim, pasi nuk zotëron kapacitetin e kërkuar ligjor dhe teknik në mënyrë të pavarur, siç kërkohej nga dokumentet e tenderit. Baza ligjore ku mund të mbështetesh (sipas rastit):

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Neni 801 e në vijim – Qiraja nuk mund të aplikohet mbi licenca që nuk janë “sende”. Ligji nr. 10081/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – përcakton që licencat janë të lidhura me subjektin dhe nuk janë të transferueshme. Akti nënligjor përkatës për sektorin (p.sh. VKM për licencat në ndërtim) – shpesh përcakton qartë që licenca nuk mund të përdoret nga palë të treta.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

4. CLEAN FAST shpk

NIPT: L61807037R

arsyet

Konstatohet se shtojca 2 (Lista e cmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit) e ngarkuar në SPE nga Operatori ekonomik “CLEAN FAST” shpk, nuk është plotësuar sipas formatit të shtojcës 2 të Dokumentave Standarte të Tenderit pasi në këtë shtojcë mungon referenca e cmimeve për njësi duke krijuar konfuzion tek KVO në zbatimin e Nenit 92 të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, të pikës 3, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për kontrollin e ofertave të kualifikuara të paraqitura mbi kontrollin e gabimeve aritmetike.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

5. ASI INVEST shpk

NIPT: M01927023H

arsyet

- Në bazë të vendimit Nr. 1837/2025, Dt. 11.12.2025 të KPP-së dhe vendimit Nr. 129/2025, datë 11.11.2025 të KSHA, me arsyetimin si më poshtë:

Automjeti i deklaruar nga OE “ASI INVEST” shpk si mjet për vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot) është i rregjistruar/liçensuar dhe i destinuar për transport mallrash të rrezikshme.

Për sa më lart, OE “ASI INVEST” shpk, nuk plotëson kërkesën e parashikuar në Dokumentet Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, pasi referuar dokumentacionit provues rezulton se, mjeti i deklaruar me targa **AA 687 DR** është Autobot për transport mallrash të rrezikshme, dhe nuk është Autobot uji ashtu siç AK ka përcaktuar në DST, përdorimi i të cilit në zbatimin e marrëveshjes kuadër me objekt: “*Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore*”, jo vetëm që do të cënonte zbatimin me cilësi dhe korrektësi të kontratës (vaditja e sipërfaqeve të gjelberta me ujë të kontaminuar), por do të sillte edhe ndotje të ambientit duke ndikuar drejtpërdrejtë në shëndetin e pacientëve dhe qytetarëve të cilët marrin shërbim në Spitalin Universitar të Traumës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

A l b G a r d e n shpk

NIPT: K37513520N

Vlera /Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 22,278,000 (njëzet e dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Totali i pikëve të marra _____

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Autoriteti Kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara** me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☒ JO ☐

Nëse Po: Vendim përfundimtar Nr.1920/2025 Datë 29.12.2025